



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI I KOMUNËS

KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA

EKSTRAKT

nga procesverbali i mbajtur më 17 qershor 2014, në takimin publik me qytetarë për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2015 - 2017 të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Mbledhja u mbajt në sallën nr. 31 dhe filloi në orën 10.10.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z. Mehmet Gashi, kryesues i Kuvendit, përkatësisht kryesues i këtij Komiteti.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm ishin anëtarët e këtij Komiteti, përkatësisht, Afrim Shabani, Bahri Blakçori, Haki Rudari, Kadri Avdiu, Kumrie Hoti, Mynavere Abdullhau – Krasniqi, Naim Çunaku, Rafet Llapashtica, ndërsa munguan, Islam Revuçi dhe Fidan Rekaliu.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe drejtorët e Drejtorive komunale, z.Muharrem Haziri, përfaqësues i OSBE-së, dhe një numër i vogël i qytetarëve.

➤ Korniza Afatmesme Buxhetore 2015 – 2017

(Qarkorja Buxhetore 2015/01 për Komunat)

Fillimisht z. Mehmet Gashi, Kryesues i Komitetit, njoftoi të pranishmit për rëndësinë e këtij takimi, dhe për propozimet – kërkesat e qytetarëve për të cilat potencoi se sigurisht se do të merren parasysh dhe do të përfshihen në projekte prioritare të Komunës. Gjithashtu Kryesuesi i njoftoi të pranishmit se deri më tani është mbajtur një takim publik me qytetarë të cilin e ka thirrur Kryetari i Komunës, takim në të cilin pjesëmarrja e qytetarëve ka qenë shumë më e madhe dhe propozimet – kërkesat e tyre kanë qenë shumë të arsyeshme, por që do të ketë edhe takime – debate publike tjera me qytetarë deri në përgatitjen e dokumentit final të buxhetit të Komunës i cili duhet të jetë i gatshëm për miratim në Kuvend më së largu deri më 30 shtator 2014.

Të nderuar, ju para vetës keni listën e projekteve prioritare për vitet 2015 dhe 2016, andaj posa të jap një fjalë hyrëse drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, ju lirshëm mund të merrni fjalën dhe të paraqitni kërkesat dhe propozimet e juaja në të cilat mund të merrni përgjigje nga drejtorët e Drejtorive dhe anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa që janë prezent këtu.

z. Isuf Latifi, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, e paraqiti fjalën hyrëse ku ndër të tjera i njoftoi të pranishmit me Qarkoren Buxhetore 2015/01, përmes së cilës Ministria e Financave ka përcaktuar kufijtë fillestar për Buxhetin komunal për vitin 2015 dhe projeksionet për 2016/17, tha se së shpejti pritet Qarkorja 02/2015, sipas së cilës nuk pritet të ketë rritje, por mund të ketë shkurtime të buxhetit.

Gjithashtu prezantoi "vizionin" e Komunës së Podujevës dhe rolin saj për ta arritur këtë. Ai prezantoi edhe grantet qeveritare për vitet 2014-2016, duke thënë se granti qeveritar për vitin 2015 do të jetë 15,632.935.00 euro, për vitin 2016 - 16,514,168.00 euro dhe për vitin 2017 - 16,608,964.00 euro. Ndërsa, të hyrat vetanake të planifikuara janë vlerësuar: 1,597.592.00 euro për vitin 2015, 1,610,025.00 euro për vitin 2016 dhe 1,615,226.00 euro për vitin 2017.

z. Rafet Llapashtica, anëtar i KPF-së, theksoi, sa për njoftim dëshiroj të potencoj se thirrja e këtij debati është bërë në bazë të nenit 52.1 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe në bazë të Udhëzimit Administrativ të Qeverisë së Kosovës. Në ligj thuhet se Komiteti për Politikë dhe Financa e thirrë një debat me qytetarë për t'i analizuar projektet, kurse unë si anëtarë i këtij Komiteti, sa jam në dijeni, dhe nëse interpretohet ky ligj, i nderuari Kryesues është dashur të thirret paraprakisht një mbledhje e KPF, mbledhje në të cilën është dashur të caktohet ky debat i cili po mbahet sot, jo pse dëshirojmë ne por që ligji e thotë ashtu, gjithashtu këtu po vërehet një pjesëmarrje e vogël e qytetarëve, afro 12 vet sepse me sa po shohim gjysma janë nga, drejtor të Drejtorive, zyrtar, anëtarë të KPF, këshilltarë të Kuvendit, nuk jam në dijeni se sa është informuar opinioni publik, andaj mendoj se kjo përbërje është shumë e vogël që sot të marrim një opinion nga qytetarët për projektet, po ashtu edhe drejtori përkatës e ka të vështirë të marr propozime nga meset e caktuara sepse mungojnë qytetarët nga mjedise të caktuara.

Kështu që konsideroj se KPF është dashur të mbaj një mbledhje dhe të cakton një takim publik të tillë por edhe të bënë një informim më të mirë të opinionit të gjerë në të gjitha lokacionet, pra mos respektimi i nenit 52 të LVL ka bërë që pjesëmarrja e qytetarëve të jetë kaq e vogël.

z. Mehmet Gashi, Kryesues i Komitetit, theksoi, unë po shohë se prezenca nuk është e kënaqshme, mirëpo thirrja është bërë me kohë dhe materiali është dërguar me kohë, po ashtu janë njoftuar të gjithë përfaqësuesit e fshatrave, arsyet nuk i di, mirëpo e përsëris që do të ketë edhe debate tjera dhe me siguri se të gjitha kërkesat do të merren nga të gjitha meset.

z. Naim Çunaku, anëtar i KPF-së, theksoi, e mbështesë në tërësi fjalimin e z.Rafet Llapashticës, i cili e theksoi se ky takim është në kundërshtim me ligjin ngase është dashur fillimisht të thirret Komiteti për Politikë dhe Financa i cili do të kishte caktuar një takim të tillë, mirëpo konsideroj se është shqetësuese, kur sot kemi të debatojmë për kërkesat dhe nevojat e qytetarëve nga lokalitete të ndryshme që ata i përfaqësojnë, të cilat i paraqesin para Komitetit për Politikë dhe Financa sepse ky është organizatorë i këtij takimi dhe ky Komitet i merr ato kërkesa dhe nevoja të tyre me qëllim që t'i inkorporoj në Kornizën Afatmesme Buxhetore gjegjësisht të jenë pjesë e Qarkores Buxhetore. Kryesuesi e përmendi një takim që është organizuar nga Kryetari i Komunës për të cilin tha se ka qenë një pjesëmarrje shumë më e madhe e qytetarëve, mirëpo unë them se ne jemi këtu si Komitet për Politikë dhe Financa për të kryer obligimin e vet ligjor në bazë

të Udhëzimit Administrativ të Qeverisë së Kosovës i cili përcakton se KPF të organizoj debat me qytetarë për nevojat dhe kërkesat e qytetarëve me qëllim që t'i inkorporoj në Qarkoren Buxhetore. Në kontekst të kësaj, shqetësimi im është, ose nuk ka qenë informimi i mirë i qytetarëve ose nuk ka qenë interesimi i qytetarëve për të marr pjesë në debat dhe për t'i shfaqur nevojat dhe kërkesat e tyre nga ato lokalitete të caktuara.

Kërkoj nga këta qytetarë të cilët janë prezent këtu, të mos hezitojnë që të marrin fjalën dhe t'i paraqesin kërkesat dhe nevojat e tyre në mënyr që të bëhen pjesë e procedurave të projekteve prioritare.

z. Haki Rudari, anëtar i Komitetit, theksoi, paraprakisht pajtohem me kolegun që ndoshta ka qenë mirë që fillimisht të thirret një mbledhje e Komitetit për Politikë dhe Financa në të cilën do të caktohej kjo mbledhje e KPF-së me qytetarë, shqetësim tjetër është edhe pjesëmarrja e vogël e përfaqësuesve të fshatrave të cilët do të kishte qenë mirë të ishin këtu prezent.

Ajo çka unë pash në dokumentin ku janë të renditura projektet prioritare mendoj se nuk është mirë e rregulluar sepse ka projekte që ndoshta përsëriten vazhdimisht në një vend dhe ka mungesa të projekteve në vende të ndryshme.

Padyshim se i gëzohem çdo investimi që bëhet, mirëpo jam kundër asaj ku bëhen investime në një lokalitet ndërsa ka mungesë të investimeve në lokalitete tjera. Në bazë të kësaj që po shohë këtu ka disa vende që nuk janë paraparë investime, të mos merret kjo si subjektive, mirëpo në fshatin Shajkoc për vitin 2015 nuk janë paraparë investime edhe pse qytetarëve të atij fshati i është premtuar se do të ketë asfaltim të rrugëve, lagja Sinani, Bekolli dhe Obrazhda kanë nevojë emergjente për asfaltimin e rrugës, ndërsa për vitin 2015 nuk figurojnë askund. Çështje tjetër të cilën e kam ngritur edhe në Kuvend është se shkolla në fshatin Shajkoc është ndërtuar, mirëpo për shkak të qarkullimit të madh të qytetarëve të cilët udhëtojnë për te liqeni i Batllavës, kërkoj që të rregullohet trotuari ngase nxënësit e asaj shkolle janë gjithherë të rrezikuar nga veturat. Pra konsideroj se investimet duhet të bëhen njëjtë në të gjitha lokalitetet sepse pjesë e buxhetit janë të gjithë qytetarët e Komunës tonë.

z. Nexhat Popova, nga fshati Letanc, theksoi, për investimet në fshatin Letanc me sa unë po shoh kemi të bëjmë vetëm me vazhdim të projekteve, dëshiroj të di se çka është punuar në atë fshat sepse thuhet vetëm vazhdim, ndërsa dihet se deri më tani asfalti dhe shkolla janë ndërtuar nga Qeveria, dhe kanalizimi është ndërtuar nga fshatarët.

Propozim konkret kam, asfaltimin, me 4 m gjerësi, të rrugës që lidhet prej shkolle në anën e djathtë të rrugës kryesore, ngase ajo rrugë është më ngarkuara me nxënës të cilët vijnë në mësimet në shkollën e Letancit, gjithashtu si prioritet kemi edhe shtrimin me asfalt ose me zhavor të rrugicave të fshatit sepse kemi rreth 40 rrugica në fshat e që janë gjendje të keqe.

z. Halil Dibrani, nga fshati Revuç, theksoi, në listën e projekteve prioritare nuk e vërejta asnjë projekt për fshatin Revuç, fshat për të cilin mendoj se më së paku është investuar, ka pasur disa investime të cilat nuk janë gjithëpërfshirëse sepse tani ka filluar rregullimi i kanalizimit mirëpo nuk janë përfshirë rreth 40 -50 familje. Ne e kemi bërë projektin, me mjete vetanake, e rrugës me rreth 4700 metra gjatësi, projekt të cilin e kemi dorëzuar para një jave në Komunë, rrugë në të cilën do të përfshihen rreth 6 lagje apo 50 shtëpi.

Nevojë tjetër emergjente kemi heqjen e mbeturinave të cilat gjenden afër rrugës në të cilën ka qarkullim të fëmijëve – nxënësve të cilët vijnë në mësimet në shkollën e fshatit Kërpimëh, e them këtë ngase mendoj se paraqitet rrezik për ata fëmijë si, prej qenve, ujqërve, sëmundjeve etj.

Gjithashtu kërkesë tjetër është, një fëmijë i fshatit i cili rreth 4 km udhëton këmbë për në shkollë me rreth 7-8 kg libra, andaj t'i sigurohet transporti atij fëmiju.

z. Ramadan Muçiqi, nga fshati Llapashticë e Epërme, theksoi, unë si ish anëtar i Komitetit për Politikë dhe Financa konsideroj që është punuar mjaft në të gjitha lokalitetet e Komunës së Podujevës ku gati të gjitha fshatrat kanë marr një pamje properëndimore dhe mendoj se me këto projekte për vitin 2015 përfundohet e gjithë infrastruktura në territorin e Komunës së Podujevës. Mendoj se duhet të bëhet një korrigjim në listën e projekteve, pikërisht në lagjen Cakaj ku ajo lagje kaherë me mjete të veta ka asfaltuar rrugën tyre, dhe mund të them me plotë të drejtë se fshati Llapashticë është fshati i cili më së shumti ka investuar në infrastrukturë me mjete të vetat.

Pra kërkesa për këtë periudhë 2015-2017 është të futen në prioritetet infrastruktura në lagjet, Ajvazi, Arifaj dhe Lutolli, gjithashtu lagja e Mulakëve që është një mjedis i thellë malorë do të kishte qen mirë që të intervenohet me zhavorr për arsye se ka rreth 15 nxënës të cilët barten nga ajo pjesë e fshatit e që është një largësi mbi 4 km. prej shkollës, gjithashtu kemi vazhdimin e kanalizimit e që është e nevojshme që të rregullohet kjo në lagjen Orzhana.

Kërkesë tjetër, për të cilën e kemi bërë edhe projektin dhe e kemi dërguar në Ministrinë përkatëse, është shkolla në jug të Llapashticës.

z. Rexhep Dauti, nga fshati Llaushë, theksoi, në këtë listë të projekteve kamë vërejtje sepse kemi disa rrugë të cilat janë ende të pa rregulluara as edhe me zhavorr dhe kanë mbetur në gjendje të mjerueshme si; rruga e Rustem Sadikut me rreth 900 m, e cila nuk është përfshirë dhe për të cilën është bërë projekti dhe është dorëzuar, lagja Dauti deri te lagja Visoka me rreth 1km, pastaj lagja Murseli, ne në vitin e kaluar në fshatin Llaushë kemi mbajtur një mbledhje të fshatit në të cilën prezent ka qenë edhe zyrtari i Komunës Ramadan Zymeri, dhe kemi bërë projektin i cili prapë nuk është futur ky projekt për lagjen Dauti. Kërkoj nga organet e Komunës që të formohet një komision dhe le të del në fshatin Llaushë në mënyrë që të shoh dhe konstatoi gjendjen e atyre rrugëve.

z. Shaban Menxhiqi, nga fshati Lupç i Epërm, theksoi, unë desha të sqarohem rreth kolektorit i cili është paraparë të ndërtohet në Lumin Lupç-Majac në vitin 2015, ndërsa kanalizimi është paraparë të ndërtohet këtë vit, dhe se kam të qartë se a duhet që të ndërtohet së pari kanalizimi e pastaj kolektori, dhe kërkoj që kanalizimi të ndërtohet në vitin 2015 ndërsa kolektori të lihet për vitin 2016. Pra projektet e parapara për fshatin Lupç nuk janë realizuar dhe kërkojmë të realizohen këto projekte, e që janë ndërtimi i një ure mbi lumin Kaçandoll sepse afro 4-5 shtëpi janë të bllokuara dhe renovimi i shkollës për të cilën kam kërkuar edhe më parë.

z. Agim Xhemajli, nga fshati Llaushë, theksoi, kamë disa kërkesa të cilat i kamë bërë edhe drejtpërdrejt Komunës, e të cilat kanë të bëjnë me disa rrugë të fshatit Llaushë ku disa prej tyre janë të pakueshme. Rruga e cila lidhë, përmendoren – shkollën e deri te rruga e Dumnicës së Epërme është rrugë në të cilën fëmijët tanë ende ecin nëpër “baltë”, rruga prej përmendurës në lagjen Fazliu, lagje nga

e cila kemi dy Dëshmorë dhe e cila ende është e paasfaltuar, pastaj rruga e cila e lidhë Skender Imerin, e cila poashtu është e pakalueshme, rruga tjetër është, nga lagja e Visokëve deri te shkolla. Pra propozoj që këto rrugë të futen në prioritete dhe të realizohen sepse paraqitet nevojë emergjente për ato rrugë.

z. Isuf Sopu, nga fshati Letanc, theksoi, mora fjalët me qëllim të plotësoj bashkëfshatarin tim i cili kërkoj të rregullohen disa rrugë në fshatin Letanc, mirëpo ajo çka unë dua të them është se në listën e projekteve ceket vetëm asfaltimi i rrugëve në fshatin Letanc por nuk ceket se cilat rrugë, e për këtë mendoj se në atë fshatë kemi shumë rrugica të paasfaltuara si dhe rrugën në lagjen Zebica e cila ka nevojë të asfaltohet do të thotë rruga nga shkolla deri te rruga Fitorja, pastaj kemi rrugën Shala, disa rrugë në lagjen e Blakçorve dhe në anën e djathtë të mulliri si dhe disa rrugë në anën e majtë te lagja e Tallovitëve. Propozim konkret e kam edhe rregullimin e kroit të fshatit Letanc, krua i cili përpara ka qenë i rregulluar dhe janë furnizuar shumë banorë të fshatit, por që nga rregullimi i kanalizimit të fshatit ka mbet jofunksional.

z. Durim Salihu, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Urban Mbrojtjes dhe Mjedisit, theksoi, lista e projekteve të cilën e keni në dispozicion nuk është listë finale por është listë e cila është bërë në bazë të prezencës së Drejtorisë në disa lokalitete dhe nevojës që është parë nga afër, mandej kontaktit me përfaqësues dhe banorë të fshatrave, por edhe në bazë të disa vizitave të cilat unë si drejtor i kam bërë në terren, dhe shumë arsyeve tjera në bashkëpunim me Drejtorinë tjera kemi ardhur deri te renditja e këtyre projekteve në këtë listë për të cilën po e ritheksoj se nuk është përfundimtare, dhe ju sugjeroj që çdo kërkesë që keni të na adresoni fizikisht, dhe kontaktojmë dhe besoj se do të vijmë deri te një përfundim pozitiv. Unë e kam përmend edhe më përpara në takime të ndryshme se në bazë të Udhëzimit Administrativ 1/2014, pa pasur projekte konkrete nuk mund të investohet më, ngase nuk mund të zhvillohen procedurat e tenderimit pa pasur projekt zbatues dhe që është obligim i qytetarit që të bënë projektin në kabanit e licencuara, ndërsa Komuna e bënë ekzekutimin e atij projekti në qoftë se hynë në projekte prioritare.

Në vazhdim do të mundohem t'i japë disa përgjigje që u parashtuan këtu;

U përmend fshati Shajkoc, unë kam kontaktuar me atë komunitet, por mungojnë projektet, konkretisht në lagjen Sinani.

Për fshatin Letanc patëm dy persona të cilët parashtuan kërkesa, unë them se në vitin 2014 fillon asfaltimi i rreth 2 km asfalt, unë personalisht kam vizituar gati të gjithë fshatin Letanc dhe çdo lagje dhe kam biseduar me gati të gjithë përfaqësuesit e lagjeve dhe ka qenë obligim i tyre që t'i sjellin projektet, ku lagjet si Talla, Zebica, Blakçori, Shala i kanë pru projektet, ndërsa ajo që ka mbet vazhdim i projekteve ka mbet shkaku që ska pas mjete dhe është mbet për vazhdim. Sa i përket fshatin Revuç, është e vërtet ajo që u tha se e kanë bërë dhe e kanë sjellë projektin në Komunë, për asfaltimin e rrugës me mbi 4 km. ku gjysma do të kryhet sivjet ndërsa çështje tjetër rreth kësaj është se sipas një analize që e kam bërë mbi 1700 m sipas projektit lidhin vetëm 2-3 shtëpi, dhe jemi duke biseduar me Drejtorin e Shërbime Publike Mbrojtjes dhe Mjedisit se qka dhe si mund të bëjmë në fazën e parë në mënyrë që të kryhet edhe ajo pjesë.

Sa i përket lagjes Cakaj në Llapashticë të Epërme, aj projekt ka hyrë në prioritetet sepse projektin e kanë bërë ajo lagje dhe kanë dorëzuar para dy muajve, mandej lagja Mulaku, Arifi, Ajvazi nuk kanë projekte, por s'do të thotë se nuk i kemi para sysh.

Sa i përket fshatit Llaushë, u përmend lagja Dauti është rrugë e shtruar me zhavorr, ndërsa për rrugët tjera të lagjeve të cekura i kam vizituar dhe biseduar me përfaqësuesit e lagjeve dhe jemi dakorduar se për ato rrugë së pari duhet të bëhen projektet zbatuese, e ato projekte zbatuese i ka bërë lagja e Visokëve, ajo Islami dhe Tashevc.

Përndryshe për çdo informacion apo paqartësi zyra ime është e hapur në çdo kohë për çfarëdo që jeni të interesuar.

z. Naim Çunaku, anëtar i Komitetit, theksoi, konsideroj se debati ka marr rrjedh tjetër nga ajo për çka jemi në këtë takim ngase kuptimi i këtij takimi është që të marrim propozimet dhe kërkesat e qytetarëve për nevoja në mjedise të ndryshme e jo që drejtorët të paraqesin arsyetimet për kërkesat e ndryshme ngase këtë duhet ta bëjnë në KPF përkatësisht Kuvend.

Jemi në dijeni se deri në miratimin final të këtij dokumenti duhet të kalojnë edhe 3-4 procedura, por pavarësisht nga kjo ne duhet të respektojmë faktin se në këtë takim jemi vetëm për të dëgjuar kërkesat dhe nevojat e qytetarëve nga mjediset e caktuara.

Gjithashtu më bërë përshtypje ajo çfarë tha drejtori z. Durim Salihu se për realizimin e projekteve komunitetet e mjediseve përkatëse janë të obliguara të punojnë projektet zbatuese, shtrohet pyetja, përse komunitetet e mjediseve të caktuara duhet ta bëjnë projektin zbatues, derisa qytetari është i obliguar të bëjë vetëm pagesën e tatimit në pronë (të shtëpive), metoda e tillë është zbatuar vetëm në periudhën emergjente kur qytetarët kanë participuar edhe në realizimin e projekteve, ndërsa në kohën e tashme qytetari mund të paraqet kërkesa për nevoja të ndryshme, e jo të punoj projekte, pra kjo praktikë duhet të ndërprehet.

Në këtë kontekst konsideroj se askush nuk mund t'ia mohoj të drejtën Kuvendit që të ndanë një shumë të caktuar për përgatitje të projekteve, e kjo gjë nuk bëhet, por është më e lehtë, sipas juve, që t'iu thuhet qytetarëve se ju duhet t'i bëni projektet, pra nuk është e ndershme që ti thuhet qytetarit se nëse doni me u realizuar ato projekte, ju duhet t'i përgatitni projektet zbatuese..

z. Hamdi Jaha, drejtor i Drejtorisë së Inpeksionit, theksoi, parafolësi e theksoi se është formë e keqe që qytetari duhet të bëjë projektin, lidhur me këtë mund të them se gjatë vitit 2001 – 2003 kur në periudhën emergjente janë punuar rrugët dhe kanalizimet kemi bashkëpunuar me një delegacion Amerikan i cili ka qenë decidiv se komuniteti duhet të participoj në realizimin e projekteve ngase me këtë projektet i ndien më afër veti.

Përndryshe mund të veprohet edhe në mënyrën e propozuar nga parafolësi i cili është këshilltarë i Kuvendit dhe aty mund të propozoi ndërsa Kuvendi mund ta miratoi që një pjesë e buxhetit të parashihet punimin i projekteve zbatuese prioritare.

Sa i përket pagesës së tatimit në pronë këtë nuk e kemi marr kurrë si kriter ngase po të veprohej në këtë mënyrë ka mjedise në të cilat nuk do të investohej fare ngase ka lokalitete që i kanë deri në 10 shtëpi e që pagesa e tyre e tatimit

në pronë është shumë simbolike, përkundër kësaj investimet në ato mjedise nuk mungojnë.

z. Kadri Avdiu, anëtar i Komitetit, theksoi, këtu jemi në debat me qytetarë dhe nuk duhet të bëjmë politikë dhe shtoi, nuk pajtohem me parafolësin lidhur me çështjen e pagesës së tatimit në pronë ngase granti i Qeverisë caktohet sipas numrit të popullsisë, andaj çështja e realizimit të projekteve nuk duhet të ndërlidhet me pagesën e tatimit në pronë.

Sa i përket pagesës projekteve zbatuese nga ana e komuniteteve lokale jam i mendimit se kjo nuk është në rregull ngase edhe pse kostoja e projekteve nuk është shumë e lartë jemi në dijeni se gjendja ekonomike dhe sociale e qytetarëve nuk është e mirë, andaj qytetarët duhet të lirohen nga kjo taksë.

z. Haki Rudari, anëtar i Komitetit, theksoi, drejtori i ceku dy çështje, tha se lista e projekteve nuk është finale, dhe përmendi kontaktet me përfaqësues të fshatrave. Tani faktikisht me këtë që u tha po fajësohen përfaqësuesit e fshatrave, unë kam vizituar fshatrat Llaushë, Dumosh, Repë, Bellopojë e shumë fshatra tjera, po ashtu kam vizituar edhe lagjen Rrahmani dhe Rudari në Dumnicë, dhe unë nuk kishe me quajtur fshatra properëndimore, ashtu siç e tha një koleg më herët, unë personalisht konsideroj se investimet janë duke u bërë në pikëpamje politike gjë për të cilën jam kundër, dhe i përkrahim çdo investim që bëhet kudo çoft ai dhe që paraqitet nevojë emergjente për atë.

Konsideroj se nuk është mirë t'i dallojmë qytetarët, dikujt t'ju themi paguani projektet e për mjedise tjera t'i paguaj Komuna.

Në fshatin Shajkoc mund të them se është investuar, por tani është mase e domosdoshme dhe emergjente të vendoset një pengesë horizontale në rrugë ngase ky fshat është transit në mes të Podujevës dhe Orllanit, andaj Drejtoria përkatëse këtë duhet ta ketë parasysh.

z. Fatmir Gashi, drejtor i Drejtorisë së Inpeksionit, theksoi, Kryesues i Kuvendit dhe anëtarë të KPF-së do të doja shumë që të ruhet fryma e debatit për çka janë ftuar qytetarët që t'i bëjnë propozimet, kërkesat, sugjerimet e tyre, andaj nuk është momenti të shtrohen çështje dhe mospajtime individuale mes anëtarëve të KPF-së, të cilët sa po e vërej janë duke i'a humbur kuptimin këtij takimi.

z. Ramadan Zymeri, nga fshati Metehi, theksoi, qytetarët artikullimin e projekteve të tyre duhet ta bëjnë në kuadër të Komiteteve të fshatrave dhe në formë të shkruar t'i përcjellin në Drejtorinë përkatëse, ashtu siç vepron fshati Metehi dhe shtoi, kërkesë e fshatit Metehi është asfaltimi i dy rrugëve dhe atë: rruga e cila vie nga kodra, dhe rruga mulliri – shkollë, gjithashtu kemi një kërkesë shumë me rëndësi e ajo është mbrojtja e shtrati të lumit të një kthesë e cila në vazhdimësi paraqet rrezikshmëri për vërshime.

z. Kumrie Hoti, anëtare e Komitetit, theksoi, sa ne jemi në dijeni në fshatin Metehi nuk ka asnjë rrugë të paasfaltuar. Kjo është dëshmi për qytetarët se nga vijne anëtarët e Ekzekutivit të Komunës, ka rrugë të asfaltuara. Parafolësi kërkoj asfaltimin e rrugëve sekondare ndërsa ka fshatra që nuk i kanë të asfaltuara as rrugët primare.

Kërkesa ime është që kërkesat e shtruar nga ana e qytetarëve të mos hasin në vesh të shurdhër, por të shqyrtohen me kujdesin më të madh.

z. Milazim Behrami, nga fshati Lladoc, theksoi, dëshiroj të parashtroj disa kërkesa të cilat janë të nevojshme dhe për të cilat konsiderojmë se janë prioritete për fshatin Lladoc, e ato janë:

Asfaltimi i rrugës në lagjen Softolli deri te Bunjakët, projekt të cilin e kemi dorëzuar në vitin 2013 dhe që nuk është realizuar.

Asfaltimi i rrugës prej lagjes së Softollëve deri te lagja e Kaçandollëve, ku njëra i ka 1200 m dhe tjetra 700 m, dhe kemi rrugën ku kanalizimi ka mbet në gjysmë në lagjen Rrahmani, Ramadani, Zejnullahu, Maksuti, Mehanja dhe lagja Abdullahu, si dhe kemi kërkesë për rrugën nga lagja Mehanja deri te Rruga e lagje Avdullahu e cila është e pakalueshme.

Mbledhja përfundoi në orën 11.30'

Procesverbalin e mbajti
Enis Sheholli

Nr. 01- 006-52837
Podujevë,
17 qershor 2014

Kryesuesi i Komitetit
Mehmet Gashi